



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 164, Datë 12.10.2017

MBI

**LICENSIMIN E SHOQËRISË “EUROBIZNES” SH.P.K., NË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA NGA HEC-ET: “LUSEN 1” ME
FUQI TË INSTALUAR 0.315 MW; “LUSEN 2” ME FUQI TË INSTALUAR 0.6 MW;
“LUSEN 3” ME FUQI TË INSTALUAR 0.6 MW; DHE ME FUQI TOTALE TË
INSTALUAR 1.515 MW.**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, gërma ”a” të Ligjit nr.43/2015, ”Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; neneve 5, gërma ” a”; 13 dhe 21 të ”Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr. 109, datë 29.06.2016 dhe nenit 15 të ”Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 12.10.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licencimin e Shoqërisë “EUROBIZNES” sh.p.k., si dhe informacionin shtesë të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie nga HEC-et: “Lusen 1” me fuqi të instaluar 0.315 MW; “Lusen 2” me fuqi të instaluar 0.6 MW; “Lusen 3” me fuqi të instaluar 0.6 MW; dhe me fuqi totale të instaluar 1.515 MW,

Konstatoi se :

- ERE me Vendimin me Nr. 130, Datë 16.08.2017, filloi procedurat për licencimin e shoqërisë “EUROBIZNES” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec-et: “lusen 1” me fuqi të instaluar 0.315 MW; “Lusen 2” me fuqi të instaluar 0.6 MW; “lusen 3” me fuqi të instaluar 0.6 MW; dhe me fuqi totale të instaluar 1.515 MW.
- Në vendimin sipërcituar është konstatuar dhe lënë detyrë për aplikuesin që: Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me Nenin 9, pika 4.1.3, gërma “c” Shtrirja gjeografike e vendit ku do të ngrihet apo zhvillohet veprimtaria duke dhënë referencatekzakte (numër parcele, numër rregjistri kadastrë) dhe të paraqitura në hartë me shkallë 1: 25000 dhe gërma “d” - • Nenin 9, pika 4.1.5, gërma “a” miratimi i pikës së lidhjes dhe gërma “b” leja e përdorimit të ujit për prodhimin e energjisë elektrike, do të njoftohet subjekti që në bazë të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

- Shoqëria “EUROBIZNES”sh.p.k., rezultoi se plotëson tërërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr. 109, datë 29.06.2016 si më poshtë:
 - Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat ” a”, ” b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gërmat ” a”, ” b”, ” c”, “d”, ” e”, ” f” dhe ” g”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gërmat ” a”, ” b”, “c” dhe ”d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
 - Dokumentacioni tekniko - ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3; 4.1.4 dhe 4.1.5), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “EUROBIZNES” sh.p.k., në aktivitetin e Prodhimit të Energjisë Elektrike nga hec-et: “Lusen 1” me fuqi të instaluar 0.315 MW; “lusen 2” me fuqi të instaluar 0.6 MW; “lusen 3” me fuqi të instaluar 0.6 MW; dhe me fuqi totale të instaluar 1.515 MW, për një afat 30 vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative brenda 30 ditëve nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI